**Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren**
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit
University of Prizren
Univerzitet Prizrena
"UKSHIN HOTI"
Pranuar me: 02.10.2020
Zyra e pranimit | Nr. i protokollit
308 | 01-215

**KËSHILLI DREJTUES**

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

**Kryesues i Këshillit Drejtues**
**Prof. Asoc. Dr. Naser Bajraktar**

**Prizren, më 03.10.2020**

Në mbështetje të nenit 17, paragrafi 3 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, duke vendosur në lidhje me kërkesën sipas referencës 04-213 të datës 09.09.2020, në mbledhjen e mbajtur më 16.09.2020, mori këtë:

## VENDIM

I. **REFUZOHET** kërkesa me nr. prot. 04 - 213, të datës 09.09.2020, parashtruar nga Lëvizja studentore për barazi "STUDIMI KRITIKË VEPRIM", përfaqësues Andor Qereti, për lirimin e të gjithë studentëve nga të gjitha tarifat për shkollim në vitin akademik 2020/2021.

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është përfundimtar për organet e Universitetit.

## Arsyetim

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 16.09.2020, pasi shqyrtoi kërkesën me nr. prot. 04-213, të datës 09.9.2020, parashtruar nga Lëvizja studentore për barazi "STUDIMI KRITIKË VEPRIM", konstatoi se në mbështetje të Statutit të Universitetit " Ukshin Hoti" Prizren, kompetent për të vendosur për tarifat është Ministria e Arsimit dhe Shkencës, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala mund të ushtrojë ankesë në Ministrin e Arsimit dhe Shkencës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Prof. Asoc. Dr. Naser Bajraktari**

Kryesues i Këshillit Drejtues

Vendimi i dërgohet:
- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Shërbimit financiar;
- Zyrës ligjore;
- Parashtruesit të kërkesës;
- Arkivit.